

KONTRATË
ANËTARËSIMI NË FONDIN E PENSIONIT VULLNETAR RAIFFEISEN

Informacion mbi Anëtarin në Fond

Emër Atësia Mbiemër.....Shtetësia.....Nr. i dokumentit të identifikimit..... (bashkëlidhur kopje e dok. të identifikimit), Datëlindja ___/___/___, Vendlindja.....Adresa..... Kodi Postar.....Tel/Cel.....email Nr. i Pasaportës (vetëm për shtetasit e huaj)i punësuar në adresa e punëdhënësit.....

Informacion mbi Shoqërinë Administruese

Raiffeisen INVEST- Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh. a e krijuar në përputhje me legjislacionin shqipëtar, regjistruar si person juridik me Vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, nr.33825, datë 18/07/2005, me NIPT nr. K51928001I, me seli në adresën: Blv. "Bajram Curri", ETC, Kati i 9-të, Tiranë, përfaqësuar nga Znj.Edlira Konini, Administratore e Përgjithshme dhe Znj.Alketa Emini,Zv. Administratore e Përgjithshme;

Informacion mbi personin e tretë që derdh kontribute në emër dhe për llogari të Anëtarit (person juridik)

Emri i personit juridik.....Selia Nr. i Niptit.....Personi i autorizuar për përfaqësim (bashk. dok. identifikues), personi i kontaktit:Telefon..... Nënshkrimi dhe vula.....

Informacion mbi personin e tretë që derdh kontribute në emër dhe për llogari të Anëtarit (person fizik)

Emër Atësia Mbiemër.....Shtetësia..... Nr. i dokumentit të identifikimit.....(bashkëlidhur kopje e dok. të identifikimit), Datëlindja ___/___/___, Vendlindja..... Adresa..... Kodi Postar.....Tel.....email Nr. i Pasaportës (vetëm për shtetasit e huaj) i punësuar në..... adresa e punëdhënësit.....Nënshkrimi.....

Shuma e kontributit:leke (..... leke).....Frekuenca e pagesës:

(Burimi i të ardhurave.....)

Deklaratë e Anëtarit në Fond

*Konfirmoj se jam informuar dhe jam dakord me kushtet e kontratës, prospektin si dhe tarifat e aplikuara nga Raiffeisen INVEST-Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a, dhe deklaroj se kam marrë një kopje të tyre.
Konfirmoj nën përgjegjësinë time se investimi i kontributeve, do të shërbejë vetëm për qëllime të ligjshme dhe njëkohësisht burimi i tyre është nga një aktivitet i ligjshëm.
Kuptoj se të dhënat e mia personale të deklaruara në këtë kontratë/ose në cdo dokument tjetër të nënshkruar apo deklaruar pranë Raiffeisen Invest sha, janë të dhëna të detyrueshme, të cilat do të përpunohen nga kjo e fundit me standartet më të larta të sigurisë si dhe konform parashikimeve ligjore në fuqi, vetëm për qëllimin e ofrimit të produkteve/ dhe/ose për të përmbushur një detyrim ligjor që Raiffeisen Invest sha mund të ketë, bazuar në aktet ligjore dhe rregullative në Republikën e Shqipërisë. Kuptoj se mbetet detyrim i imi të përditësoj këto të dhëna, sa here që do të ndryshohen. Gjithashtu, deklaroj se jam njohur me faktin se kam të drejtë, që në cdo kohë, me anë të një kërkesë paraprake me shkrim, t'i kerkoj Raiffeisen Invest sha, që të korrigjoj apo të fshijë të dhënat e mia personale.*

Përpunimi i të dhënave personale

RAIFFEISEN INVEST - Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a. Adresa: Blv "Bajram Curri", ETC, Kati i 9-të, Tiranë, Shqipëri • Tel.: +355 4 2 277 901 • Fax: +355 4 2 277 905

Deklaroj se informacioni i dhënë nga ana ime në këtë kontratë është i vërtetë dhe i saktë. Une shpreh pelqimin tim qe Raiffeisen INVEST sha te mbledhe te dhenat e mia personale te deklaruar ne kete kontrate, si edhe t'i perpunoj me tej ato vetem per qellimin e ofrimit te sherbimit per te cilin po aplikoj. Kuptoj se çdo e dhene personale lidhur me personin tim do te trajtohet me nje nivel sigurie te stadarteve me te larta ne perputhje te plote me parashikimet e Ligjit nr. 9887 date 10.03.2008 "Per Mbrojtjen e te Dhenave Personale" dhe aktet nenligjore te nxjerra ne zbatim te tij, si edhe perputhje me parashikimet e bera ne "Rregulloren e Pergjithshme Europiane Per Mbrojtjen e te Dhenave Personale" GDPR.

Gjithashtu, deklaroj dhe jap miratimin tim per procesimin e metejshe me te dhenave personale nga ana e Raiffeisen INVEST sha, duke i transferuar keto te dhena drejt paleve kontraktore, te cilat mund te jene ne cilesine e perpunuesit ne kuader , te celjes, mirembajtjes dhe administrimit te llogarise.

Ne kete kuader, jam njohur me faktin qe te dhenat e mia personale i transferohen subjektit Banka e Pare e Investimeve sh.a ne cilesine e Depozitarit te fondit bazuar ne Ligjin nr. 10197, date 10.12.2009 "Per fondet e pensionit vullnetar" si dhe subjektit Raiffeisen Bank sh.a Shqiperi & CRISP Centralised Raiffeisen International Services & Payments S.R.L me seli ne Bukuresht-Rumani, ne menyre qe shoqeria te ushtroje vigjilencen e duhur si edhe te zbatoje detyrimet e tjera qe burojne nga legjislacioni ne fuqi ne fushen e parandalimit te pastrimit te parave.

Autorizoj ne menyre te shprehur Raiffeisen INVEST sha, qe te ruaje te dhenat e mia personale per nje afat deri ne 11- vite pas mbylljes se marredhenies se biznesit mes meje dhe shoqerise. Jam njohur nga shoqeria me faktin qe per çdo pyetje apo informacion lidhur me menyren e perpunimit te te dhenave te mia personale kam te drejtete dergoj e-mail ne adresen elektronike: rba.dataprotection@raiffeisen.al.

Gjithashtu, kuptoj se bazuar ne dispozitat e GDPR dhe Ligjit per Mbrojtjen e te Dhenave Personale si dhe akteve nenligjore te nxjerra ne zbatim te tij, une mund te ushtroj ne çdo kohe te drejten per akses, drejten per te kerkuar kerkuar bllokimin, korrigjimin ose fshirjen e te dhenave personale qe perpunohen nga ana e Raiffeisen INVEST sha. Gjithashtu ne cdo kohe ruaj te drejten per t'u ankuar tek Komisioneri per te Drejten Informimit dhe Mbrojtjen te dhenave Personale" dhe ruaj te drejten per t'u terhequr nga dhenia e pelqimit per perpunim te te dhenave.

Data e lidhjes së kontratës.....

Vendi: Tiranë

Anëtari

(Emer mbiemer firme)

Raiffeisen INVEST- Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a

përfaqësuar nga

Edlira Konini
Administratore e Përgjithshme

Alketa Emini,
Zv/ Administratore e Përgjithshme

Miratimi për perpunimin e të dhënave personale në rast ofertash promovionale

Jap miratimin tim të pakushtëzuar që Raiffiesen INVEST sha, të përdorë të dhënat e mia personale për qëllimin e përfitimit nga ana ime të ofertave promovionale, si pjesë e paketës së produkteve/shërbimeve që Shoqëria ofron(apo do të ofrojë në të ardhmen), nëpërmjet një ose disa prej kanaleve të informimit, duke përfshirë por pa u kufizuar në: i) postë zyrtare; ii) sms ;iii) telefonate; iv) postë elektronike etj. Në këtë kuadër autorizoj Raiffeisen INVEST sha, që duke respektuar standartet më të larta të sigurisë, si dhe bazuar në dispozitat ligjore dhe rregullative në fuqi, të delegojë perpunimin e metejshe me të dhënave të mia personale, duke i transferuar këto të dhëna tek palë të treta të specializuar për këtë qëllim. Gjithashtu, deklaroj se jam njohur me të drejtën që në cdo kohë të kërkoj nga Shoqëria revokimin e këtij miratimi.

Unë pranoj

Unë nuk pranoj

Neni 1 OBJEKTI

Objekt i kësaj kontrate është rregullimi i marrdhënieve të ndërsjellta midis Anëtarit të Fondit (në vijim Anëtari) dhe Raiffeisen INVEST- Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a (në vijim Shoqëria Administruese), që rrjedhin nga anëtarësimi në Fondin e Pensionit Vullnetar Raiffeisen (në vijim Fondi), me qëllim investimin e aseteve dhe ofrimin e perfitimeve për pension, mbështetur në Ligjin nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për Fondet e Pensionit Vullnetar”(në vijim Ligji), aktet nënligjore në zbatim të tij, si dhe rregulloret e brendshme të Shoqërisë Administruese.

Neni 2 BAZA LIGJORE

Kjo kontratë është bazuar në nenin 6 të Ligjit nr. 10197, date 10.12.2009 “Për fondet e Pensionit Vullnetar” dhe nenin 3 të Rregullores nr. 2 datë 13.01.2011 “Për përmbajtjen e kontratës dhe të prospektit të fondit të pensionit”

Neni 3 ANËTARËSIMI NË FOND

- 3.1 Cdo person mund të anëtarësohet në Fond duke lidhur një kontratë anëtarësimi me Shoqërinë Administruese.
- 3.2 Formulari standart i aplikimit, i cili është pjesë përbërëse e kësaj kontrate përfshin deklaratën personale të Anëtarit, i cili duke e nënshkruar pranon kushtet e kontratës si dhe konfirmon se është njohur dhe ka kuptuar plotësisht prospektin e Shoqërisë Administruese.
- 3.3 Shoqëria Administruese do të hapë një llogari personale për çdo Anëtar, sipas kontratës së lidhur.

Neni 4 PAGESA E KONTRIBUTEVE

- 4.1 Shuma e kontributit përcaktohet nga çdo anëtar, por jo më pak se 1000 (njëmijë) lekë në muaj.
- 4.2 Kontributet do të derdhen në llogarinë e Fondit nr.AL782151 1031 ALL1 0000 0393 3000 pranë Bankës së Parë të Investimeve, Albania sh.a, e cila do të kryejë funksionin e Depozitarit të Fondit.
- 4.3 Anëtari mund të zgjedhë frekuencën e pagesës së kontributeve e cila mund të jetë: mujore, me një periodicitet tjetër **apo si një shumë totale**. Pavarësisht nga frekuenca e pagesës së kontributeve që mund të zgjedhë Anëtari, në çdo rast shuma do të jetë në përputhje me paragrafin 4.1 të këtij neni.
- 4.4 Asetet e Anëtarit në Fond përbëhen nga kontributet në para, të bëra në emër dhe për llogari të Anëtarit, dhe nga kthimi i investimit të bere me këto kontribute, pas zbatimit të zbritjeve të nevojshme, sipas dispozitave ligjore dhe kontratës.
- 4.5 Shoqëria Administruese konverton në kuotë pensioni, sipas cmimit të kuotës në ditën e pagesës së kontributit, kontributet e investuara në Fond dhe asetet e transferuara nga një fond tjetër. Çdo kuotë pensioni përfaqëson një pjesë përpjesëtimore pronësie në secilën nga asetet e Fondit. Vlera totale e kuotave në Fond është gjithmonë e barabartë me vlerën totale neto të aseteve të Fondit.
- 4.6 Proçedura e detajuar e konvertimit të kontributeve të paguara nga Anëtari në kuota përcaktohet në prospektin e Shoqërisë Administruese i cili është pjesë përbërëse e kësaj kontrate.
- 4.7 Nëse Anëtari ndërpret pagesën e kontributeve, ai mbetet anëtar në Fond, dhe ka të njëjtat të drejta si anëtarët e tjerë të Fondit.

Neni 5 POLITIKA E INVESTIMIT

- 5.1 Asetet e Fondit do të investohen sipas parimit të sigurisë afatgjatë dhe të një kthimi të pershtatshëm nga investimi, duke ruajtur një raport optimal mes rritjes së kursimeve për pension dhe riskut të marrë persiper.
- 5.2 Asetet e Fondit do të investohen në instrumenta të sigurtë dhe ku një pjesë e të cilave do të jete likuide.
- 5.3 Portofoli i fondit do të perbehet kryesisht nga letra me vlerë afatgjatë (me maturim me të lartë se një vit) të emetuara dhegarantuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë. Pjesë perberëse e portofolit do të jene edhe letrat me vlerë afatshkurter të emetuara dhe garantuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë.
- 5.4 Kufijtë e alokimit të aseteve do të jenë si më poshtë:

SHPËRNDARJA E ASETVE TË FONDIT			
Instrumenti	Minimumi	Objektivi	Maksimumi
Tituj të emetuar dhe garantuar nga qeveria e Republikës së Shqipërisë	50%	95%	100%
Tituj të emetuar dhe garantuar nga shtete të Bashkimit Europian, OECD-se, Banka Boterore, Banka Qendrore Evropiane, Banka Evropiane e Investimeve	0%	0%	100%
Depozita bankare dhe cash	0%	5%	100%
Instrumenta borxhi me rating BBB (S&P), Baa3 (Moody's), BBB (DBRS)	0%	0%	30%
Kuota të Fondeve të Investimit ose indekse aksionesh: CAC 40, DAX, FTSE, S&P 500, Dow Jones, Nikkei 225, Sensex, All Ordinaries and Hang Seng	0%	0%	30%

5.5 Anëtari pasi bie dakord me këtë kontratë dhe prospektin, merr përsipër riskun e investimit të Fondit.

Neni 6 DEPOZITARI

- 6.1 Shoqëria Administruese ka lidhur një kontratë me Bankën e Pare të Investimeve, Albania sh.a, me seli në adresën Bul. "Dëshmorët e Kombit", Kullat Binjake, Kulla 2, Kati 14, Tiranë, e cila në përputhje me ligjin nr. 10197, datë 10.12.2009 "Mbi fondet e pensionit vullnetar", do të ofrojë shërbimet e Depozitarit për asetet e Fondit.
- 6.2 Depozitari do të jetë përgjegjës për ruajtjen e Aseteve të anëtarëve në Fond. Depozitari kontrollon administrimin e asetëve të Fondit nga Shoqëria Administruese, në përputhje me dispozitat e kontratës, prospektin si dhe të legjislacionit në fuqi.
- 6.3 Depozitari është një entitet tërësisht i pavarur nga Shoqëria Administruese, dhe çdo palë tjetër të lidhur me të, i cili siguron që të gjitha të ardhurat e fondit të pensionit do të shpërndahen në përputhje me Ligjin dhe kontratën.

Neni 7 TË DREJTAT DHE DETYRIMET E SHOQËRISË ADMINISTRUESE

Shoqëria Administruese merr përsipër :

- Të administrojë me efektivitet asetet e anëtarëve në fond, nëpërmjet diversifikimit të investimeve, me synim rritjen e asetëve të anëtarëve;
- Të ofrojë pensione dhe përfitime të tjera tek anëtarët, sipas kushteve dhe procedurave ligjore;
- Të informojë çdo anëtar lidhur me prospektin e Shoqërisë Administruese përpara se të nënshkruajë kontratën;
- Të paktën çdo 30 ditë, duhet të informojë çdo Anëtar për asetet, përfshirë vlerësimin e vlerës neto të asetëve të Anëtarit në Fond, datat e kontributeve dhe transferimet e asetëve të bëra nga ose në emër të Anëtarit gjatë periudhës përkatëse dhe shndërrimin e këtyre kontributeve të asetëve në kuota pensioni, sipas mënyrave të parashikuara në Ligj;
- Të respektojë konfidencialitetin e llogarisë individuale të çdo Anëtarit, dhe të japë informacion mbi asetet vetëm tek Anëtarët e Fondit, personat e autorizuar nga Anëtarit, si dhe në rastet e tjera të parashikuara nga Ligji;
- Të informojë në çdo kohë Anëtarët për sa i përket ndryshimeve në politikën e investimit, si dhe rregulloret përkatëse që krijojnë efekte për Anëtarët.
- te sigurojë për çdo Anëtar akses kontrolli në çdo kohë në gjendjen e llogarisë së tij/saj online.
- Të kryejë transferimin e asetëve, mbështetur në kërkesën me shkrim të Anëtarit, si në rastin e transferimit në një Fond tjetër të menaxhuar nga e njëjta Shoqëri Administruese, ashtu edhe në rastin e transferimit në një Fond të menaxhuar nga një tjetër Shoqëri Administruese.

Neni 8 TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ANËTARIT

- 8.1. Anëtari ka të drejtat e detyrimit e mëposhtme:
- Të ketë në çdo kohë pronësinë e asetëve të investuara në Fond;
 - Të përfitojë pagesën e menjëhershme të vlerës neto të asetëve ose pagesat periodike në formë pensioni sipas kushteve dhe procedurave ligjore;
 - Të informohet në periudha të rregullta kohore, dhe të paktën çdo 30 ditë, mbi vlerën neto të asetëve në llogarinë e tij të pensionit;
 - Të transferojë asetet e akumuluar në një Fond tjetër, i cili administrohet nga e njëjta ose nga një tjetër Shoqëri Administruese. Në rastin e transferimit të asetëve, Anëtari përfundon kontratën e mëparshme si dhe lidh një kontratë anëtarësimi në fondin tjetër të pensioneve vullnetare;
 - Të ketë një fond pensioni të trashëgueshëm.

7.2 Gjithashtu Anëtari merr përsipër:

RAIFFEISEN INVEST - Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a. Adresa: Blv "Bajram Curri", ETC, Kati i 9-të, Tiranë, Shqipëri • Tel.: +355 4 2 277 901 • Fax: +355 4 2 277 905

- a) Të përcaktojë shumën e kontributeve që do të paguajë, të ndryshojë këtë shumë si dhe dinamikën e pagesës së kontributeve, sipas zgjedhjes së tij;
- b) Të informojë menjëherë dhe jo më vonë se 10 ditë Shoqërinë Administruese lidhur me ndryshimet e kushteve që kanë të bëjnë me anëtarësimin në Fond;
- c) Të informojë Shoqërinë Administruese për çdo ndryshim tek të dhënat personale.

Neni 9 TRANSFERIMI I ASETETEVE

- 9.1 Anëtarit ka të drejtë që, në çdo kohë, të transferojë asetet e veta nga një fond pensioni në një tjetër, i cili administrohet nga e njëjta ose nga një tjetër shoqëri administruese.
- 9.2 Nëse anëtarit në një fond pensioni, "fond i mëparshëm i pensionit", vendos të bashkohet me një tjetër fond pensioni, "fondi i ri i pensionit", ai duhet të njoftojë shoqërinë administruese, që administron fondin e mëparshëm të pensionit, që ai ka vendosur të transferojë asetet e veta në një tjetër fond pensioni të administruar nga e njëjta shoqëri administruese ose nga një tjetër shoqëri administruese dhe që shuma në llogarinë e tij, pasi të jenë bërë zbritjet përkatëse, në përputhje me kontratën e fondit të pensionit, duhet të transferohet në fondin e ri të pensionit.
- 9.3 Transferimi i aseteve në fondin e ri duhet të përfundojë jo më vonë se dita e parë e punës pas 10 (dhjetë) ditësh pune, pasi shoqëria administruese e fondit të mëparshëm të pensionit ka marrë njoftimin nga Anëtarit.

Neni 10 PAGESA E PËRFITIMEVE

- 10.1 Anëtarit i fondit të pensionit, sipas zgjedhjes, ka të drejtë të marrë pagesën e menjëhershme të vlerës neto të aseteve në llogarinë e vet ose pagesat periodike, në formë pensioni, që i përgjigjen kësaj vlere:
 - a) 5 vjet përpara se të mbushë moshën e pensionit, të parashikuar me Ligj për sistemin e pensionit të detyrueshëm, që zbatohet për atë Anëtar;
 - b) kur bëhet i paaftë për punë në mënyrë të përhershme dhe që vërtetohet, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- 10.2 Pagesa e menjëhershme e vlerës neto të aseteve do të kryhet në bazë të kërkesës me shkrim të Anëtarit, në llogarinë e tij, jo më vonë se 30 ditë nga marrja e kërkesës;
- 10.3 Pagesat periodike në formë pensioni do të kryhen mbështetur në një marrëveshje të vecante që do të lidhet midis Anëtarit dhe Shoqërisë Administruese, kur Anëtarit plotëson kushtet e parashikuara nga Ligji për të përfituar.
- 10.4 Me qëllim përfitimit e pagesës së të gjithë aseteve të veta në Fond, Anëtarit i paraqet një kërkesë me shkrim Shoqërisë Administruese, shoqëruar me të gjithë dokumentacionin që vërteton plotësimin e kushteve për të bërë tërheqjen, i cili përcaktohet në rregulloren e miratuar nga Shoqëria Administruese.

Neni 11 TËRHEQJA E PARAKOHSHME

- 11.1 Anëtarit ka të drejtë që të tërheqë asetet nga llogaria individuale e Fondit përpara plotësimit të kushteve të parashikuara në nenin 10 të kontratës. Shoqëria Administruese kryen pagesën e vlerës neto të aseteve në llogarinë e Anëtarit, brenda 30 ditësh nga marrja e kërkesës së Anëtarit për tërheqje të parakohshme.
- 11.2 Në rastin e tërheqjes së parakohshme Shoqëria Administruese do të aplikojë penalitete të cilat do të llogariten mbi vlerën neto të aseteve, dhe më konkretisht:
 - 2% për cdo tërheqje të parakohshme të kryer pas 20 vitesh nga data e kontributit të parë.
 - 5%, për cdo tërheqje të parakohshme kryer në periudhën kohore që fillon pas 10 vitesh nga data e kontributit të parë deri në 20 vjet nga data e kontributit të parë, përfshirë edhe vitin e 20-të;
 - 10%, për cdo tërheqje të parakohshme të kryer në periudhën kohore që fillon pas 5 vitesh nga data e kontributit të parë deri në 10 vjet nga data e kontributit të parë, përfshirë edhe vitin e 10-të;
 - 15%, për cdo tërheqje të parakohshme të kryer në periudhën kohore deri në 5 vjet nga data e kontributit të parë, përfshirë edhe vitin e 5-të;
- 11.3 Në rastin e vdekjes së Anëtarit penaliteti i tërheqjes së parakohshme nuk aplikohet.

Neni 12 PAGESA E ASETETEVE NË RASTIN E VDEKJES SË ANËTARIT

Në rastin kur Anëtarit vdes përpara se të marrë pagesën e të gjithë aseteve të veta, asetet në llogarinë e tij/saj u shpërndahen

RAIFFEISEN INVEST - Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a. Adresa: Blv "Bajram Curri", ETC, Kati i 9-të, Tiranë, Shqipëri • Tel.: +355 4 2 277 901 • Fax: +355 4 2 277 905

trashëgimtarëve në përputhje me dispozitat ligjore që rregullojnë trashëgiminë.

Neni 13 TARIFAT E SHOQËRISË ADMINISTRUESE

Shoqëria Administruese do të aplikojë tarifate e mëposhtme :

- a) Tarifa e administrimit të Fondit do të jetë 1,5 % në vit e vlerës neto të asetëve të Fondit. Vlera neto e asetëve përbëhet nga vlera e përgjithshme e asetëve e zvogëluar nga zbritja e detyrimeve dhe tarifave deri në datën e vlerësimit.
- b) Tarifa e administrimit të Fondit do t'i ngarkohet asetëve të Fondit në fund të çdo dite, dhe do të mbahet në fund të çdo muaji si shumë e vlerës ditore për atë muaj
- c) Në rastin e transferimit të asetëve nga Anëtarit në një Fond tjetër të menaxhuar nga një Shoqëri tjetër Administruese, tarifa që do të aplikohet do të jetë 0,5 % e shumës së transferuar.
- d) Çdo ndryshim i tarifave që do të aplikohen nga Shoqëria Administruese, do t'u njoftohet Anëtarëve në Fond të paktën 12 muaj përpara.

Neni 14 KOHËZGJATJA E KONTRATËS

- 14.1 Kjo kontratë lidhet për një afat të pacaktuar, dhe do të sjellë pasojat ligjore vetëm pasi të jetë bërë pagesa e e parë e kontributit.
- 14.2 Kontrata do të përfundojë :
 - a) Kur të gjitha asetet e Anëtarit janë transferuar në një tjetër Fond Pensioni;
 - b) Në rastin e tërheqjes së parakohshme të të gjitha asetëve në fond;
 - c) Në rastin e vdekjes së Anëtarit.

Neni 15 KONFIDENCIALITETI DHE MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

- 15.1 Raiffeisen Invest sha,ruan konfidencialitetin në lidhje me informacionin e dhënë nga klienti, si dhe të dhënat e llogarisë.
- 15.2 Raiffeisen Invest Sha është e detyruar të raportojë këtë lloj informacioni vetëm me kërkesë të organeve kompetente në përputhje me Legjislacionin Shqiptar.

Neni 16 GJYKATA KOMPETENTE

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis palëve të kësaj kontrate do të zgjidhet me mirëkuptim, në të kundërt kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të jetë Gjykata e Shkallës së Parë, Tiranë.

Neni 17 DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

- 17.1 Ndryshimet dhe shtesat në kontratë do të bëhen me mirëkuptim të palëve si dhe do të marrin miratimin e Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare në të gjitha rastet që kërkohet nga Ligji.
- 17.2 Me lidhjen e kësaj kontrate çdo marrëveshje e mëparshme e lidhur midis palëve shfuqizohet.
- 17.3 Kjo kontratë hartohet në dy kopje, nga një për secilën palë.
- 17.4 Në rastin kur një person i tretë paguan kontribute në emër dhe për llogari të Anëtarit, kontrata do të hartohet në 3 kopje origjinale nga një për secilën palë, përfshirë edhe personin e tretë që paguan kontribute.